

Kombetarja fiton 4-0 miqesoren me U-19

nga AlbaniaSoccer
E premte, 21 Maj 2010 20:18



Kombetarja kuqezi ne kuader te pergatitjeve per miqesoren me Malin e Zi, ka zhvilluar sot pasdite nje ndeshje kontrolli kunder kombetares U-19. Ne kete takim trajneri Josip Kuzhe ka provuar te gjithë lojtaret qe mund ta nisin titullar kunder malazezeve dhe kjo ndeshje ka perfunduar me rezultatin 4-0. Golat mbajne firmen e Salihit, Liles, Veliajt dhe Kapllanit. Ky takim miqesor eshte zhvilluar ne stadiumin e Luzit dhe kroati i kombetares shqiptare ka ngelur i kenaqur nga ky test kontrolli.

Enea Shtrepi